




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPKI
 Nr. i faq. _____
 Broj stranice 02

Nr Prot. _____
 Br. Prot. 06-1721/20
 Prot No. _____
 Data _____
 Datum 21.08.2020

PRISHTINE



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.08.2020, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. *AKK-DPKI-06/2844/19*, për zyrtarin e lartë z. Ferki Xhaferi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPKI-06/2844/19*, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ferki Xhaferi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), pasi ka identifikuar rastin për zyrtarin e lartë z. Ferki Xhaferi, ka verifikuar informacionin ku i njëjti figuronte si person i autorizuar në biznesin privat Avokaturën " Ferki Xhaferi " B.I. Agjencia fillimisht me shkresën zyrtare Nr. *DPKI-06-2564/19*, ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare Nr. *DPKI-06-2564/19*), rezulton se zyrtari i lartë z. Ferki Xhaferi është person i autorizuar në biznesin në fjalë.

Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare Nr. *AKK-DPKI-06/413/20*,

dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të tij është organizuar dhe mbajtur një takim në Agjencinë kundër Korrupsionit, ku zyrtari i lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, ushtrimi i funksionit të Gjyqtarit duke qenë njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat Avokaturën “ Ferki Xhaferi ” B.I, paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, situatë e cila është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Ferki Xhaferi, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se prej emërimit në pozitën e Gjyqtarit, nuk ka ushtruar asnjë lloj veprimtarie me biznesin në fjalë. Gjithashtu zyrtari i lartë ka deklaruar se do të ndërmarr veprime tjera konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Me datë 18.08.2020, Agjencia ka pranuar shkresë zyrtare Nr.DPKI06-413-1/20, me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Ferki Xhaferi, ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat Avokatura “ Ferki Xhaferi ” B.I.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çka konstatohet se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znoj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

